



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.428/2021
Datë: 30 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, 1.17 dhe 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në vazhdimin e takimit 274-të, të mbajtur me datë 30 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi KGJK.nr.03/2020, i datës 27 janar 2020, për plotësimin e kriterëve për shpërndarjen automatike të lëndëve përmes SMIL-it për Gjykatat Themelore, si në vijim:
 1. Caktimi i anëtarëve të trupit gjykues dhe panelit, në rastet kur nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve në dispozicion për të caktuar anëtarët e trupit gjykues dhe panelit në departamentin përkatës, caktimi bëhet në mënyrë automatike përmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL).
 2. Lëndët e dhunës në familje në lëminë civile dhe penale, do t'u caktohen në mënyrë automatike dhe rastësore gjyqtarëve të cilët kanë ndjekur trajnimin për lëndët e dhunës në familje, ndërsa lista e gjyqtarëve që do të ngarkohen me këto lëndë do caktohet nga kryetari i gjykatës.
 3. Në procedurën jokontestimore lëndët do të caktohen në mënyrë automatike dhe rastësore, ndërsa lista e gjyqtarëve që do të ngarkohen me këto lëndë do caktohet nga kryetari i gjykatës.
 4. Në procedurën përmbartimore lëndët do të caktohen në mënyrë automatike dhe rastësore, ndërsa lista e gjyqtarëve që do të ngarkohen me këto lëndë do caktohet nga kryetari i gjykatës.
 5. Në procedurën e sigurimit të kërkesëpadisë (lidhur me caktimin e masës së sigurimit dhe masës së përkohshme të sigurimit), lëndët do të caktohen në mënyrë automatike dhe rastësore, ndërsa lista e gjyqtarëve që do të ngarkohen me këto lëndë do caktohet nga kryetari i gjykatës.
- II. Për zbatimin e vendimit për pikat e sipër theksuara, vlen kriteret e aprovuara paraprakisht.
- III. Të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre, obligohen në zbatimin e tyre.

- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, kurse zbatimi pas krijimit të kushteve teknike.


Arsyetim

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.03/2020, të datës 27 janar 2020, ka miratuar kriteret për shpërndarjen e lëndëve në gjykatat e Republikës së Kosovës përmes sistemit të menaxhimit informativ të lëndëve (SMIL) dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Shpërndarja automatike e lëndëve që ka filluar zbatimin nga muaji shkurt 2020, ka shfaqur nevojën e përmirësimit të mëtejme sa i përket funksionimit më të mirë dhe efikas të këtij procesi.

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe zhvillimit efektiv të shpërndarjes, KGJK, në takimin e datës 30 dhjetor 2021, ka ndryshuar dhe plotësuar vendimin KGJK.nr.03/2020, duke plotësuar kriteret për shpërndarjen automatike të lëndëve në caktimin e trupave gjykues dhe shpërndarjen e lëndëve tek gjyqtarët të cilët kanë ndjekur trajnimin për dhunë në familje, për lëndët e procedurës jokontestimore, përmbartimore dhe në procedurën e sigurimit të kërkesëpadisë (lidhur me caktimin e masës së sigurimit dhe masës së përkohshme të sigurimit).

Andaj nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- TIK/SMIL;
- Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.